

PROGRAMI I TRANSPARENCËS AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit- AKSHI Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës AKSHI (këtej e tutje autoriteti publik AP) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. AKSHI do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së AKSHI-it, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare <http://akshi.gov.al/> si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e AKSHI– it është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së AKSHI janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: AKSHI ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e AKSHI dhe përkatësisht: Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 703 datë 23.04.2015 ‘Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit’.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, A K S H I vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.akshi.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinators për të drejtën e informimit;

- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të funksioneve dhe shërbimeve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AKSHI, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- AKSHI gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga AKSHI.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT.

	Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura Përgjegjëse
1	Përshkrimi i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni7/1/a/ d	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	Menuja përkatëse në faqe zyrtare: Struktura	Koordinatori. Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit
2	Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Menjëherë pas hyrjes në fuqi të aktit	Në menunë përkatëse në faqen zyrtare të internetit: http://www.akshi.gov.al/legjislacioni	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit
3	Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g	Menjëherë	Në faqen zyrtare të internetit http://www.akshi.gov.al/informacion/programi-transparencesakshi	Koordinatori Sektori i Asistencës së Qytetarit.
4	Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorsit për të drejtën e informimit.	Neni7/1/ç	Menjëherë	Në faqen zyrtare të internetit http://www.akshi.gov.al/informacion/koordinatori-per-te-drejtene-informimit	Koordinatori Sektori i Asistencës së Qytetarit.

5	Mekanizmat monitorues; raporte auditit; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Menjëherë	Në faqen zyrtare të internetit http://www.klsh.org.al/	Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit
6	Buxheti	Neni 7/1/e	Menjëherë pas miratimit	Në faqen zyrtare të internetit http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti	Titullari
7	Informacion për procedurat e tenderimit	Neni 7/1/ë	Menjëherë	Në faqen zyrtare të internetit https://www.app.gov.al/ep/REGJ	Drejtoria e Kërkimit & Zhvillimit E- GOV
8	Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f	Menjëherë	Në faqen zyrtare të internetit http://akshi.gov.al/pki/	Sektori i Asistencës së Qytetarit
9	Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj	Menjëherë	Në faqen zyrtare të internetit http://akshi.gov.al/akshi/strategjia/	Sektori i Asistencës së Qytetarit
10	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 Të Ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i	Menjëherë pas miratimit nga titullari	Në faqen zyrtare të internetit_ Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit
11	Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Menjëherë	Në faqen zyrtare të internetit http://akshi.gov.al/	Koordinatori
12	Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l	Menjëherë	Në faqen zyrtare të internetit http://akshi.gov.al/	Koordinatori

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AKSHI vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.akshi.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	Dr. Mirlinda Karçanaj Drejtor i Përgjithshëm Arsimi: Diplomë në Informatikë, Universiteti i Tiranës. Periudha e studimit: 1991-1996 (me kohë të plotë) Arsimi pasuniversitar: Master në Informatikë me drejtim "Sisteme e bazave të të dhënave" -Universiteti i Tiranës. Periudha e studimit: 2001-2005 Diplome Doktorate në Informatike (Grada Shkencore “Doktor”) Periudha e përfundimit: Dhjetor 2012	Pas botimit në fl/zyrtare. Përditësohet pas çdo akt emërimi	Në faqen zyrtare të AKSHI-t Kontakt	Sektori i Financës
--	--------------	--	---	--	--------------------

Daniel Shima – Zevendës drejtor Përgjithshëm,

Diplomuar për “Ekonomi Biznesi” në Universitetin Shtetëror “St. Cloud”, Shtetet e

Bashkuara të Amerikës, Periudha: 2009-2014

Diplomuar: Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidhshmëri” në

Universitetin e Tiranës, Periudha: 2014 – 2016

Besian Arizi- Drejtor, Drejtorja e Vazhdimësisë së Punës BCC, Back up dhe DRC

Diplomuar: Bachelor në Shkenca Kompjuterike në Universitetin “La Sapienza”, Rome, Itali Tiranë

Periudha: 2002-2009.

Diplomuar: Për Teknologji Informatike në Universitetin e Tiranës-Fakulteti i Shkencave.

Periudha: 2006 - 2009

Certifikata trajnimesh në fushën e Menaxhimit të Rrjetit, Administrimit të Serverëve, etj,

Eriona Pecallari- Drejtor, Drejtorja Juridike dhe e Statistikave e-Gov dhe TIK

Diplomuar: Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Periudha: 1999 – 2003.

Certifikata trajnimesh në legjisllacionin e fushës e-qeverisjeje Certifikata trajnimesh në legjisllacionin e fushës TIK

Certifikata trajnimesh në fushën e Prokurimeve Publike

Yrgys Çela – Drejtor, Drejtorja e Bazave të të Dhënave Shtetërore

Diplomuar: “Inxhinieri Naftë”, Universiteti Politeknik i Tiranës Periudha: 2000-

2005.

Certifikata trajnimesh në fushën e TIK.

Valmir Proganati – Drejtor, Drejtorja e Kërkimit dhe Zhvillimit e-Gov

Diplomuar në Elektronikë

Universiteti Politeknik, Tiranë, Periudha: 2000-2010.

Fatjon Hallkaj - Drejtor, Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit

Diplomuar: Bachelor diplomuar në Fakulteti i Shkencat e natyrës, Universiteti Tiranës në 2012 - 2015

Master Shkencor ne Informatike ne 2018 Universiteti Tiranës

Romina Kostani - Drejtor, Drejtoria e Inovacionit dhe IPA Sektoriale

Diplomuar: Bachelor në Informatikë ,

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Periudha: 2008-2011.

Master Shkencor në Sisteme Informacioni

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Periudha: 2011-2013

Puna: Drejtor, Drejtoria e Inovacionit dhe IPA Sektoriale e-Gov

Tetor 2018 – aktualisht.

Nevila Repishti - Drejtor, Drejtoria e Portalit Qeveritar e-Gov

Master Shkencor ne Informatike ne 2007

Universiteti I Shkodres “Luigj Gurakuqi

Ervin Muça - Drejtor, Drejtoria Tik e Ministrise se Financave

Diplomuar: Bachelor dhe Master në Inxhinieri Elektronike në Univeristetin Politeknik të Barit, Itali

Periudha:2002 -2009

Diplomuar: Master në Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit në universitetin Kurt Bösch, Zvicër

Periudha:2011 -2013

Certifikata trajnimesh në fushen e menaxhimit dhe dizenjimit të rrjetit, menaxhimit të serverave, menaxhimit të projekteve

Marko Cela Drejtor i Drejtorise se Infrastruktures e-Gov

Bachelor: diplomuar në Fakulteti i Shkencat e natyrës, në 2012

Master Shkencor ne Informatike Ekonomike në 2014 Univesriteti European i Tirane

Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d	Ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999 «Statusi nëpunësit Civil » Ligji Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"	Menjëherë pas përfundimit të procedurës së përcaktuar në ligj Urdhër emërimi	Në faqen zyrtare të AKSHI	Spektori i Financës
Mekanizmat monitorues; Raporte auditit; Dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Raporte monitorimi dhe auditimi. (KLSH & MF); "Raport Monitorimi Vjetor" (i gjithë informacioni)		Në faqen zyrtare të AKSHI	AKSHI

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.